

KËRKESË

- KËRKUES:** Arbër ÇEKAJ, përfaqësuar nga i biri i Selim dhe Feride, i datëlindjes 05.04.1980, lindur në Bajram Curri dhe banues në Njësinë Bashkiake Nr.2 Sauk Tiranë, i përfaqësuar nga Av. Dritan JAHAJ, avokat pranë zyrës së avokatisë “HAXHIA &HAJDARI”, me Nr. NIPT. K81317053M, me adresë Blv “Dëshmorët e Kombit”,Nd.6, H.11, Ap.21, Njësia Administrative nr. 5,
- OBJEKTI:** Vendosjen e masës disiplinore ndaj prokurorit **Edvin KONDILI**.
- DREJTUAR:** Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- NË VËMENDJE:** Kryetarit Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
Z. Gent IBRAHIMI.
- BAZA LIGJORE:** Neni 101, 102, 111e vijues të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 149/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
-

Të Nderuar anëtarë të Këshillit Lartë të Prokurorisë,

Z. Alfred BALLA,
Z. Arben DOLLAPAJ,
Z. Besnik CANI,
Z. Bujar SHESHI,
Znj. Esmeralda CAMI,
Z. Kostaq BELURI,
Znj. Nurihan Seiti METAJ,
Z. Sandër BECI
Z. Tartar BAZAJ,
Z. Vatë STAKA,

I Nderuar Z. Kryetar,
Z. Gent IBRAHIMI.

1. Në seancën gjyqësore të datës 20 Nëntor 2019, prokurori i çështjes Ervin Kondili i ka paraqitur Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, fakte dhe provat të rreme që tregonin të kundërtën (pafajësinë e të pandehurve) në favorin e tij, duke shpërdoruar detyrën dhe funksionin që ai ka.
2. Nga ana e prokurorit Ervin Kondili është paraqitur prova se i pandehuri Arbër ÇEKAJ sipas **Proces Verbal për Kqyrjen dhe Marrjen e Provës Materiale datë 28.02.2018, e marrë nga oficeri i policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, Migena Haxhi, Më datë 28.02.2018 është bërë kqyrja e të dhënave të sistemit TIMS për shtetasin Arbër ÇEKAJ dhe ka rezultuar se dalja e fundit e regjistruar është datë 12.03.2015 nëpërmjet pikës së Kalimit Kufitar Rinas dhe hyrja e fundit më datë 11.02.2018 ora 21:55 nëpërmjet pikës Kufitare Murriqan.**
3. Ky fakt është paraqitur në mënyrë të qëllimshme për të fajësuar dhe rënduar pozitën e të pandehurit Arbër ÇEKAJ, **ndërkohë që nga prova e depozituar nga prokurori rezulton që dalja e fundit e shtetasit Arbër ÇEKAJ rezulton sipas sistemit TIMS që është data 07.02.2018 ora 02:20, por nga sistemi TIMS rezulton se nga viti 2015 ky shtetas ka rreth pesëdhjetë (50) dalje jashtë Republikës së Shqipërisë dhe jo një siç ka pretenduar prokurori në konkluzionet përfundimtare ku ka kërkuar dhe dënimin e shtetasit Arbër ÇEKAJ me 21 vite burgim, bazuar mbi këtë provë.**
4. Më datë 24.12.2019, pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është depozituar kallëzimi penal ndaj prokurorit Edvin KONDILI, me objekt “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me palë kallëzuese shtetasi Arbër ÇEKAJ.
5. **Neni 149 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se,** *“Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.”*
6. **Neni 149/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi:**
 - a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;
 - b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;
7. **Neni 4 i ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” përcakton se,** *“1. Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi. 2. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik.”*

8. **Në nenin 8 të ligjit 97/2016, përcaktohet se,** “Prokurorët sigurojnë trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykim për të gjithë personat, pavarësisht gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjubës, bindjeve politike, fetare a filozofike, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, pronës, arsimimit, lindjes, aftësisë së kufizuar, origjinës shoqërore, përkatësisë prindërore ose për arsye të tjera.”
9. **Në nenin 3 të ligjit 96/2016, përcaktohet se,** “ 1. Magjistrati ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. 2. Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye. 4. Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykim. 5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces.”
10. **Në nenin 101 të ligjit 96/2016, përcaktohet se, Magjistrati kryen shkelje disiplinore në këto raste:**
- kur vepron me pakujdesi në ushtrimin e detyrave që rrjedhin nga funksioni, sipas parashikimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni;
 - kur haptazi nuk i referohet ligjit ose fakteve për shkak të pakujdesisë së rëndë, siç përcaktohet në treguesit e pikës 2, të këtij neni, ose dashjes, ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale;
 - në çdo rast tjetër që, në mënyrë të pajustificuar, kryen akte dhe sjellje të papërshtatshme gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose që dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë.
2. Pakujdesia në ushtrimin e detyrës nga magjistrati konsiderohet shkelje disiplinore vetëm në rastet kur vërehen gabime, të cilat tejkalojnë ato që mund të ndodhin në rrethana normale nga një magjistrat mesatar. Kufijtë midis çështjeve që kanë lidhje me ushtrimin e funksionit dhe shkeljeve të disiplinës nga magjistrati caktohen duke marrë në konsideratë këta tregues:
- shkallën e pakujdesisë;
 - shpeshtësinë e kryerjes së gabimit;
 - pozicionin e magjistratit në sistem;
 - nëse fusha e ligjit, në të cilën magjistrati ushtron funksionin, vlerësohet si shumë e ndërlikuar, e re ose nuk është zhvilluar sa duhet nga jurisprudenca gjyqësore ose e prokurorisë;
 - mundësinë e ardhjes së dëmit dhe intensiteti i pasojave të mundshme nga shkelja; si dhe
 - çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme me keqfunksionimin e sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë si një i tërë.
3. Në zbatim të këtij neni, shkeljet kryhen përmes veprimit dhe mosveprimit të magjistratit. Magjistrati që kryhen shkeljet disiplinore, në veçanti në rastet e parashikuara në nenet 102 deri në 104, të këtij ligji, ka përgjegjësi disiplinore sipas këtij ligji.
11. **Në nenin 105 të ligjit 96/2016, përcaktohet se Këshillat mund të vendosin një ose më shumë nga këto masa disiplinore:**

- a) vërejtje konfidenciale;
- b) vërejtje publike;
- c) ulje e përkohshme e pagës;
- d) ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër;
- e) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave;
- f) shkarkim nga detyra.

12. **Neni 8/a i Kodit të Procedurës Penale ka përcaktuar se,** *“Organi procedues duhet të mbledh dhe të shqyrtojë si provat që fajësojnë të pandehurin, ashtu edhe ato që janë në favor të tij.”*

13. Nga dispozitat e cituara më sipër kuptohet qartë, që prokurori që ushtron ndjekjen penale, nuk ka kompetencë të ngrejë akuzën dhe paraqes provat sipas bindjes së tij të brendshme, por ai e ushtron detyrën e tij duke respektuar ligjin, Kushtetutën, Marrëveshjet Ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. **Ligji 96/2016, neni 8/a i Kodit të Procedurës Penale por edhe KED e detyrojnë prokurorin që të mbledhë dhe shqyrtojë edhe provat që janë në favor të të pandehurit.**

14. Duke u bazuar në analizën ligjore të fakteve dhe provave, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kërkojmë nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të vendosi masën disiplinore shkarkimin nga detyra të prokurorit Edvin KONDILI.

Me respekt,

Përfaqësuar me prokurë të posaçme nga

Av. Dritan JAHAJ
